

## **Fjala e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, z. Besnik Dervishi, në hapje të Takimit të 17-të të Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave Personale të Evropës Qendrore dhe Lindore - CEEDPA.**

Në vitin e gjashtë të veprimtarisë së zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sot në Durrës organizohet takimi i 17-të i autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave Personale të Evropës Qendrore dhe Lindore. Me këtë rast, përshëndes përfaqësuesit e vendeve anëtare të kësaj organizate:

Bosnjë–Hercegovina, Bullgaria, Gjeorgjia, Hungaria, Polonia, Mali i Zi, Maqedonia, Republika Çeke, Serbia, Sllovakia dhe Ukraina.

Ne e kemi zgjeruar pak rrethin e pjesëmarrësve jo vetëm nga pikpamja gjeografike. Përshëndes për pranimin e ftesës dhe pjesëmarrjen edhe autoritet e Italisë dhe të Marokut.

Ndërkohe, ne do të diskutojmë e vendosim edhe për anëtarësimin e autoritetit të Mbrojtjes së të Dhënave të Kosovës në organizatën tonë.

Këtë takim e nderon me pjesëmarrjen e tij edhe Zv/presidenti i Zyrës së Mbikqyresit Evropian të Mbrojtjes së të Dhënave Personale, ku më lejoni të përshëndes dhe të falenderoj në mënyrë të veçantë Zv/presidentin, zotin Wiewiorowski.

Gjithashtu, këtë takim e nderon me pjesëmarrjen e saj edhe anëtarja e Byrose së Komitetit të T-PD të Keshillit të Evropës, znj. Sarishvili.

***Takimi i Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave të vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore, i shërben vlerësimit të ndërsjelltë të eksperiencave më të mira në mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe krijimit dhe unifikimit të praktikave të përbashkëta.***

Autoriteti shqiptar e konsideron zhvillimin, diskutimet, eksperiencën dhe vendimmarrjen e këtij Takimi, si një vlerë të shtuar në objektivat e përbashkëta të vendeve tona.

***Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Shqipërisë, kërkon që me veprimtarinë e saj të qëndrojë në standartin e autoriteteve të vendeve me një praktikë të konsoliduar.***

Kjo gjë është bërë e mundur edhe nga pjesëmarrja aktive e kësaj Zyre në të gjithë forumet ndërkombëtare të mbrojtjes së të dhënave.

***Zyra është angazhuar në plotësimin e kuadrit ligjor dhe rregullator, në dhënien e opinionëve për aktet normative, në ndërgjegjësimin e individëve për të garantuar të drejtën kushtetuese të mbrojtjes së të dhënave personale, në administrimin e ankesave në rritje, në kryerjen e inspektimeve me tematika të caktuara në kontrollues që veprojnë në fusha sensitive dhe me ndjeshmëri të lartë, si dhe në rekomandime edhe unifikuese për masa që duhen marrë në sektorë të veçantë, apo në vendimmarrje e sanksione administrative.***

Ndërkohë, Zyrës së Komisionerit, që prej nëntorit të vitit të kaluar, me miratimin e ligjit të ri për të Drejtën e Informimit, i është shtuar edhe kjo detyrë, duke e rritur edhe më tej përgjegjësinë, por edhe sfidat e Zyrës që unë drejtoj.